

LIGJ
Nr.7550, datë 20.1.1992

PËR POLICINË E OBJEKTEVE

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Policia e objekteve është pjesë e policisë së rendit dhe ka si detyrë ruajtjen dhe sigurimin e objekteve ekonomike, politiko- shoqërore e kulturore të personave juridikë e fizikë.

Neni 2

Në policinë e objekteve bëjnë pjesë dega e policisë së objekteve në Drejtorinë e Policisë së Rendit në qendër dhe komandat e reparteve e nënreparteve të saj në bazë.

Neni 3

- a) Me miratim të Këshillit të Ministrave për objektet më të rëndësishme.
- b) Me marrëveshje ndërmjet Ministrisë së Rendit Publik dhe ministrisë ose institucionit tjetër qendror për objektet e tjera shtetërore.
- c) Me marrëveshje ndërmejt policisë së objekteve dhe pronarëve ose administratorëve të tyre, për objektet private dhe selitë e partive e të organizatave politike e shoqërore.

Neni 4

Procedura e lidhjes së kontratës për ruajtjen e objekteve shtetërore përcaktohet me udhëzim të Këshillit të Ministrave.

Procedura e lidhjes së kontratës për objektet private dhe selitë e partive e të organizatave politike e shoqërore, përcaktohet me udhëzim të ministrit të Rendit Publik.

Neni 5

Personat juridikë e fizikë përballojnë të gjitha shpenzimet për ruajtjen e objekteve të tyre nga policia e objekteve.

Të ardhurat e vjelura nga ky shërbim i kalojnë Ministrisë së rendit Publik nëpërmjet buxhetit të shtetit.

Personat juridikë e fizikë që kanë në pronësi ose administrim objektin, detyrohen që të japin fonde për pajisje teknike të nevojshme, mjete transporti e ndërlidhjeje, të sigurojnë kushte normale për punë e jetesë për nevojat e policisë së objekteve, sipas parashikimit në kontratë.

Neni 6

Në rast se në objekte ndodhin vjedhje ose dëmtime, për shkak të moskryerjes së rregullt të detyrës nga efektivi i policisë së objekteve, dega e Rendit ngarkohet me përgjegjësi materiale, sipas dispozitave në fuqi dhe kushteve të parashikuara në kontratë.

Neni 7

Kur personi juridik a fizik nuk plotëson detyrimet që janë parashikuar në kontratë, policia e objekteve ka të drejtë të kërkojë plotësimin e tyre ose zgjidhjen e kontratës.

Neni 8

Policia e objekteve ka për detyrë:

- Të marrë masa për ruajtjen dhe sigurimin e jashtëm fizik të objekteve që ruhen prej saj.
- T'i kërkojë drejtuesit të objektit vendosjen e rregullave të brendshme për hyrjen dhe daljen e punonjësve a të personave të tjerë në objekt.
- Të kërkojë nga gjithë punonjësit dhe personat e tjerë të jashtëm që hyjnë në objekt, zbatimin e rregullave të vendosura dhe të marrë masat përkatëse ndaj atyre që i shkelin ato.
- Të kontrollojë masat e sigurimit të objektit, si rrethimin, ndriçimin, gatishmërinë e sistemit të ndërlidhjes, mbrojtjen nga zjarri, vendet e shërbimit e masa të tjera sigurimi dhe për çdo parregullsi të verë në dijeni drejtuesin e objekteve, duke kërkuar riparimin e shpejtë të tyre.
- Të marrë masat parandaluese ndaj gjithë pesonave që mbajnë me vete lëndë ose mjete të rrezikshme për sigurimin e objektit dhe që dyshohen se mund t'i përdorin në mënyrë të kundërligjshme.
- Të bashkëpunojë me forcat e tjera të policisë së rendit dhe policinë financiare në kryerjen e detyrës.
- Të raportojë te drejtuesi i objektit për detyrat e kryera prej saj.

Neni 9

Policia e objekteve ka të drejtë:

- Të ndalojë personat që kanë kryer vepër të kundërligjshme në objekt, të grumbullojë e të ruajë prova materiale sipas rregullave të përcaktuara me ligj.
- Të hyjë në zyrat e objektit dhe në mjediset e tjera për të parandaluar veprimet kriminale dhe kapjen e autorëve të tyre, për t'u dhënë ndihmën e nevojshme të dëmtuarve, ose për arsye të tjera që parashikohen nga ligji nr.7504, datë 30.7.1991 "Për policinë e rendit".

Neni 10

Për shkelje të rregullave të vendosura për ruajtjen dhe sigurimin e objekteve punonjësi i policisë së objekteve ka të drejtë të gjobitë në vend kundërvajtësit deri në 500 lekë.

Neni 11

Ndalohet përdorimi i forcave të policisë së objekteve për shërbime e detyra të Ministrisë së Rendit Publik, që nuk janë përcaktuar me këtë ligj.

Neni 12

Ngarkohet Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Rendit Publik të nxjerrë aktet përkatëse në zbatim të këtij ligji deri në fund të muajit shkurt 1992.

Neni 13

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë.

Shpallur me dekrete nr.117, datë 28.1.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Ramiz Alia.